

STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA "A.E.K. SECURITY"

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerit tregtare" si dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" me vullnet te lire,duke u mbeshtetur edhe ne Aktin e Themelimit qe i bashkalidhet ketij statuti, Une ortaku themelues Z.Arben Kazazi i biri i Idrizit i datelindjes 09.07.1964,banues ne lagjen "Deshmoret e Kombit" Berat me zotesi te plote juridike per te vepruar,vendosa te hartoje kete statut te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "A.E.K. SECURITY" si me poshte vijon:

FORMIMI I SHOQERISE

Neni 1

Ortaku themelues Arben Kazazi ne baze te Aktit te Themelimit te nenshkruar prej tij ka themeluar shoqerin me pergjegjesi te kufizuar me emerin "A.E.K. SECURITY" sh.p.k

FORMA E SHOQERISE

Neni 2

Shoqeria "A.E.K. SECURITY" eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbjen vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te ortakeve themelues ne kapitalin e themelimit.

QENDRA,TERITORI

Neni 3

Selia e shoqerise "A.E.K. SECURITY" sh.p.k ndodhet ne ish Kombinatin Tekstile Berat. Shoqeria mund te hape edhe filiale,perfaqesi,agjensi operative ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqipares.

Me miratimin e organeve kompetente shteterore,shoqertia mund te hape edhe fililale dege,perfaqesi,agjensi te saj edhe jashte vendit.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise "A.E.K. SECURITY" do te jete me afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet,duke filluar ky afat i dorezimit te ketij statuti te shoqerise si person juridik prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfare do shkak duke kryer me pare te gjitha veprimet e likujdimit sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

OBJEKTI I VEPRIMTAREISE

Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise "A.E.K. SECURITY" me seli ne ish Kombinatin Tekstile Berat do te jete:

1.Ruajta dhe sigurimi i objekteve publike dhe private,sigurim i jetes i shtetasve vendas dhe te huaj.

KAPITALI I SHOQERISE



Neni 6

Kapitali Themelor i shoqerise eshte 4.000.000 (katërmiljon) lek dhe eshte kontribut i ortakut te vtem themelues te shoqeroise.

Kapitali themelor eshte i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 40.000 lek per kuote.

Kapitali themelor zoterohet teresisht (100%) nga ortaku themelues i shoqerise Z.Arben Kazazi.

Kapitali themelor mund te shtohet ose pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve.

Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

Pjeset e kapitalit themelor jane plotesisht te transferushme ne rruge trashëgimnie,por ato mund te transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne ortakeri,por gjithmon me vendim te asamblese se ortakeve dhe me akt noterial konform ligjit.

Fitimi qe do te realizohet gjate veprimtarise ekonomike te shoqerise do te administrohet nga asamblea e ortakeve.Nje pjese e ketij fitimi do te perdoret per investime dhe zgjerimin e aktivitetit.

Ky fitim do te disponohet lirisht prej asamblese se ortakeve,pasi shoqeria te kete shlyer me pare detyrimet ligjore.

Per kryerjen e veprimtarise se saj,shoqeria do te hape njesi prodhimi,sherbimi dhe do te bashkepunonje me persona fizike e juridik vendas dhe te huaj.

Shoqeria mund te ushtroje edhe aktivitete te tjera ne perputhje me legjistacionin ne fuqi, te konsideruara me perfitim dhe te dobishme per aritjen e objektivave te saj kryesore.

ORGANIZIMI DHE DREJKTIMI

Neni 7

Asambleja e ortakeve te shoqerise emerom si Administrator te shoqerise "A.E.K. SECURITY" sh.p.k Z.Arben Kazazi me afat 5(pese) vjet,afat i cili fillon menjeher me dorezimin e keti statuti ne Q.K.R.

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte derejtues dhe vendimor i shoqerise,ajo ushtron gjithë kompetencat qe i jep ligji "Per tregtaret dhe shoqerti tregtare."

Me vendim te asamblese se ortakeve shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake,shtetas shqiptar apo te huaj ose te bashkohet me nje shoqeri tjeter brenda dhe jashte vendit.

Asambleja e ortakeve mund te delegoje kompetencat nje ose me shume administratoreve te emeruar prej saj ose dhe nje personi fizik jashte ortaksise se shoqerise vetem mbi bazen e prokures noteriale.

Asambleja e ortakeve te shoqerise ka kompetence te emeruje si administrator edhe nje person tjeter jashte shoqerise duke i caktuar atij pagen dhe detyrat e tjera ne perputhje me legjistacionin ne fuqi dhe statusin e kesaj shoqerie.Afati i emerimit nuk mund te jete me i gjate se 5(pese) vjet dhe mund te rizgjidhet.

Administratori i emeruar nga asambleja e ortakeve e humbet detyren etij ne rastin e prishjes se shoqerise ose ne cdo kohe me vendim te asamblese se ortakeve.

ADMINISTRATORI I SHOQERISE

Neni 8

Administratori i shoqerise ka keto kompetenca:



Organizon dhe drejton veprimtarine operative te shoqerise ne perputhje me ligjet ne fuqi, aktin e themelimit dhe statutin.

Administron pasurine e shoqerise.

Disponon firmen ne llogarite perkatese te shoqerise ne banke.

Perfaqeson shoqerine ne maredhenjet me te tretet.

Vendos per marjen ne pune dhe largimin nga puna te punonjese te shoqerise, nxjerjen e tyre ne asistencë si dhe menyren e shperblimit te tyre, cakton dhe jep lejet e zakonshme. Mban regjistrin themelitar te punonjesve, evidenton punen e tyre dhe kur eshte rasti mer masa disiplinore sipas ligjit.

Ndjek ritmikisht aktivitetin ekonomik te shoqerise, si dhe cakton kontabilistin per mbajtjen e kontabilitetit te shoqerise.

Mban pergjegjesi per likuidimet ne kohe te detyrimeve te shoqerise ndaj shtetit sipas legjislacionit fiskal dhe te detyrimeve ndaj paleve te treta.

Perfaqeson shoqerine para organeve gjyqesore dhe administrative ose autorizon persona te tjere kompetente.

Kryhen veprime juridike ne emer dhe per llogari te shoqerise me te trete si; lidhje kontrata, ben celje te kredive, kryhen veprime te ndryshme bankare, doganore, tregtare, financiare dhe cdo veprimtari tjeter kontraktore ose jashte kontraktore qe eshte ne interes te shoqerise dhe cdo veprim tjeter qe percaktohet ne ligj.

VITI FINANCIAR DHE LLOGARITE VJETORE

Neni 9:

Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar ka filluar ditën e themelimit si person juridik.

Llogarite vjetore, inventari, raporti mbi veprimtarin e vitit financiar te hartuar nga administratori, kontabilisti i miratuar apo eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga asambleja e ortakeve te shoqerise.

Bilanci vjetor i shoqerise nxiret brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

Shoqeria "A.E.K. SECURITY" sh.p.k te ardhurat do ti realizoje nga ushtrimi i veprimtarise private te saj.

Cmimet dhe tarifat e sherbimeve caktohen me vendim te asamblese se ortakeve te shoqerise dhe ne perputhje me kerkes-oferten dhe dispozitat ligjore ne fuqi.

MARDHENJET E PUNES

Neni 10

Maredhenjet e punes ne shoqeri regullohen nepermjet kontrates se punes.

Per problemet qe nuk parashikohen ne kontrate zbatohen dispozitat ligjore ne foqi "Kodi i Punes ne R.SH".

Shoqeria "A.E.K. SECURITY" sh.p.k mer persiper te respektoje te gjitha regullat ne fuqi te sigurimeve shoqerore e shendetsore, ndersa punonjesit detyrohen te respektojne aktet ligjore ne fuqi, kete statut dhe kontraten e punes.

Te punesuarit ne kete shoqeri perligjen para ligjit dhe ketij statuti per mos respektimin e detyrave dhe per demet e shkaktuara. Te gjithë punonjesit jane te detyruar te ruajne sekretin e shoqerise edhe pas largimit nga kjo shoqeri.

SHPERBERJA E SHOQERISE



Neni 11

Shperberja e shoqerise behet ne cdo kohe dhe per cdo lloj shkak. Shoqeria priset para kohe kur:

1. Aktiviteti ekonomik i saj per disa vjet radhazi eshte me humbje.
2. Per arsye te parashikuar ne ligj.
3. Dhe ne cdo rast tjetër me vendim te asamblese se ortakeve.

Menyra e likuidimit te shoqerise eshte kompetence eskluzive e asamblese se ortakeve te saj. Asambleja e ortakeve cakton nje ose me shume likuidator per te nxjere rezultatet e aktivitetit te shoqerise.

DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 12

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "A.E.K. SECURITY" sh.p.k fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit te saj. Shoqeria eshte person juridik Shqiptar dhe zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjistacionit shqiptar ne fuqi, me Statut dhe Akt Themelimin e saj.

Neni 13

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "A.E.K. SECURITY" sh.p.k eshte person juridik i pavarur. Ajo ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet me ligj.

Neni 14

Asambleja e Ortakeve te shoqerise ka te drejte qe ne perputhje me ushtrimin e veprimtarise se saj te beje ndryshime ne kete statut.

Neni 15

Shoqeria duhet te kete vulen e saj. Vula duhet te mbaje stemen dhe shkrimet e nevojshme qe tregojne emrin e shoqerise.

Neni 16

Per te gjitha mosmareveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata ku ndodhet selia ligjore e shoqerise.

Neni 17

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut ne lidhje me kompetencat e ortakut te vetem dhe te gjitha kushteve te tjera do te bazohet ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerit tregtare" si dhe ligjin nr.9723 date 03.05.2007"Per Qendren Kombatre te Regjistrimit" me ndryshimet perkatese.

PER SHOQERINE "A.E.K. SECURITY"
ORTAKU THEMELUES
(Arben KAZAZI)

Berat, me 06.06.2011

